



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 05.04.2016

PËR

NDRYSHIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL PËR GAZSJELLËSIN TRANS
ADRIATIK (PROJEKTI TAP)


Në mbështetje të neneve 5, 7, 17 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, të pikës 27.1, të nenit 27, dhe të pikës 6/1/b, nënndarja “iii”, e pjesës 1, të shtojcës 1, të Ligjit Nr. 116/2013, datë 15.04.2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes me Qeverinë e Vendit Pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Vendimit Nr. 62, datë 27.01.2016, “Për miratimin e zbatimit të procedurës së thjeshtuar për ndryshimin e Planit Kombëtar Sektorial për gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP), të miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 04.07.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP)”, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP, miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 04.07.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit, përfshirë materialin grafik dhe shtojcat si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pikat 2, 3, 4 dhe 5 të Vendimit Nr. 1, datë 04.07.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)”, ruajnë të njëjtën vlefshmëri edhe sipas këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGJISË DHE INDUSTRISË



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

